



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 751 / Prot.
13

Vlorë më, 24.02.2025

VENDIM

Nr. 16, datë 24.02.2025


PËR

MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE NUMRIT MAKSIMAL TË UDHËHEQJES SË TEMAVE TË DIPLOMËS PËR PERSONELIN AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 38, 73, 75, 79 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 24.02.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë numrin maksimal të udhëheqjes së temave të diplomës për personelin akademik të UV-së si më poshtë vijon:
 - a) Udhëheqësit me titullin akademik 'Profesor' mund të drejtojnë ≤ 3 doktorantë njëkohësisht, dhe ata me titull akademik 'Profesor i asociuar' ≤ 2 brenda dhe jashtë institucionit (Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë (24.12.2021), Shtojca nr.6, Standarti III.2, Kriteri 2).
 - b) Numri maksimal i udhëheqjes shkencore të njëkohëshme të temave të diplomës në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, për personelin akademik të UV-së të jetë ≤ 6 , përveç udhëheqjeve shkencore në ciklin e tretë të studimeve.
 - c) Ky numër përfshin udhëheqjet shkencore në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, ku personeli akademik është i angazhuar (neni 79 / pika 6 i Ligjit 80/2015).
 - d) Të drejtën e udhëheqjes shkencore në programet e ciklit të tretë të studimeve e ka stafi akademik me kohë të plotë i kategorisë Profesor.
 - e) Të drejtën e udhëheqjes shkencore në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve e ka stafi akademik me kohë të plotë që zotëron minimalisht gradën shkencore Doktor Shkencash.
 - f) Hierarkia e akordimit të udhëheqjeve shkencore është si vijon:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Udhëheqjet shkencore të programeve mësimore të njësisë bazë shpërndahen brenda departamentit sipas rendit:

- titulli Profesor,
- titulli Profesor i asociuar,
- grada shkencore PhD në vendet e BE,
- grada shkencore Doktor Shkencash.

Nëse numri i kërkesave të studentëve për të përfunduar studimet me punim shkencor është më i madh se kapacitetet e personelit akademik të njësisë bazë, drejtuesi i departamentit mund të përzgjedhë për udhëheqje shkencore personel akademik nga njësitë e tjera bazë të fakultetit, sipas të njëjtit rend hierarkik si brenda departamentit.

2. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Administratorit, Zëvendësrektorit Akademik dhe Njësisë Kryesore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliq